



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 mars 2020
Nr. ref.:RK 1532/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI109/19

Parashtrues

Mehmet Qerimi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 5/19,
të 22 janarit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mehmet Qerimi, me vendbanim në fshatin Muhovc, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [Pml. nr. 5/19] i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 22 janarit 2019.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur e ka pranuar më 16 shkurt 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 qershor 2019, parashtruesi përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 28 qershor 2019, kërkesa e parashtruesit kishte arritur dhe ishte regjistruar në regjistrin e Gjykatës.
8. Më 3 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
9. Më 16 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 19 nëntor 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Ferizaj, për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzonin në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
11. Më 9 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Ferizaj dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
12. Më 16 janar 2020, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës, që në përputhje me nenin 32 të Rregullores së punës, ta nënshkruante formularin e kërkesës.

13. Më 27 janar 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës.
14. Më 26 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 24 prill 2013, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti Aktakuzën [PP/II. nr. 531-4/13] kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar, se ka kryer veprën penale [Vjedhje] nga neni 252 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).
16. Më 23 korrik 2015, Gjykata Themelore në Ferizaj, me Aktgjykimin [P. nr. 783/13], shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale për të cilën akuzohej, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajsh, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohej nëse parashtruesi brenda një viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe e obligoj parashtruesin që në emër të kërkesës pasurore–juridike të të dëmtuarit M. S. ta kompensojë në shumën prej 4800 euro.
17. Më 16 tetor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit [P. nr. 783/13] të Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal.
18. Më 8 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 1421/2015], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke vërtetuar Aktgjykimin [P. nr. 783/13] e Gjykatës Themelore në Ferizaj. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit theksoi se pretendimet e parashtruesit nuk qëndrojnë ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë.
19. Më 28 mars 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Ferizaj, duke pretenduar se janë paraqitur prova të reja të cilat do të ndikojnë në pafajësinë e tij si dhe kërkoi shtyerjen e ekzekutimit të Aktgjykimit [PA1. nr. 1421/2015] të Gjykatës së Apelit.
20. Më 21 qershor 2018, Gjykata Themelore në Ferizaj, përmes Aktvendimit [PK..238/18] hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar asnjë provë të re e cila do të ndikonte në rishikimin e procedurës penale.
21. Më 5 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PK..238/18] të Gjykatës Themelore në Ferizaj, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë.
22. Më 14 gusht 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 789/2017] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke konsideruar se Aktvendimi [PK..238/18] i Gjykatës Themelore në Ferizaj, nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale.

23. Më 12 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
24. Më 22 janar 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 5/2019] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga parashtruesi, duke theksuar se *“gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar kërkesën për rishikimin e procedurës penale, pasi që prova të cilën e ka cek mbrojtësi i të dënuarit dhe atë CD-në ka qenë objekt i vlerësimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë kur i dënuari Mehmet Qerimi është shpallur fajtor”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
26. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkelje të ligjit penal.
27. Lidhur me shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] parashtruesi i kërkesës pretendon se *“nëse të pandehurit do t’i dorëzoheshin të gjitha provat e përmendura në shkresat e lëndës (CD-ja) i njëjti do të lirohej nga përgjegjësia penale”*.
28. Lidhur me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës vetëm thekson se parashtruesi *“duhet të gëzojë të drejtën në mbrojtjen gjyqësore si të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës”*.
29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizon vendimin e kontestuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë,

Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

33. Në fillim, Gjykata i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar dhe datës së parashtrimi të kërkesës në Gjykatë për të vlerësuar nëse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajve.
34. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi [Pml. nr. 5/2019] i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 22 janarit 2019.
35. Në bazë të fletëkthesës të cilën Gjykata Themelore në Ferizaj e ka dorëzuar në Gjykatë, në përgjigjen e saj të 19 nëntorit 2019, Gjykata vëren se parashtruesi vendimin e kontestuar e ka pranuar më 16 shkurt 2019.
36. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 16 shkurt 2019, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 26 qershor 2019, që do të thotë se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
37. Gjykata përsërit se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe për të parandaluar autoritetet dhe palët e tjera të interesuara që të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë më të gjatë kohore (Shih Vendimin e GJEDNJ-së, *Olivier Gaillard kundër Francës*, nr. 47337/99, të 11 korrikut 2000, shih Vendimin e GJEDNJ-së *Franz Hofstädter kundër Austrisë* nr. 25407/94, 12 shtator 2000).
38. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqes kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur (shih: Vendimi i GJEDNJ-së *O’Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtresa nr. 23274/04), dhe të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik.
39. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i

tillë nuk është më i mundur (shih Vendimi i GJEDNJ-së *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, i 25 janarit 2000, shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sabri Güneş kundër Turqisë*, i 29 qershorit 2012, paragrafi 40).

40. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse kërkesa e parashtruesit është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 26 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi